



Në  
këtë  
periodik  
në të lexoni:

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive  
e AMF-së takon drejtues të lartë  
të Zyrës së Asistencës Teknike  
të Departamentit Amerikan të Thesarit

Tregu i sigurimeve, janar-korrik 2024

20 24 **VËSHTRIM MBI TREGJET**

4

**ZHVILLIME TË TJERA**

5-8

**INFORMACIONE  
NDËRKOMBËTARE**

9-11

## **Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së takon drejtues të lartë të Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit**



*Tiranë – 20 gusht 2024*

Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, zhvilloi një takim me përfaqësues të lartë të Zyrës së Asistencës Teknike të Departamentit Amerikan të Thesarit (OTA) të kryesuar nga znj. Paula Jones, këshilltare e lartë për shërbimet financiare.

Ky takim zhvillohet në kuadër të projektit që AMF po zbaton me financim nga Departamenti Amerikan i Thesarit me fokus kryesor rritjen e standardeve për mbrojtjen ndaj rreziqeve të sigurisë kibernetike dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemeve të teknologjisë së informacionit të Autoritetit, edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e sigurimeve.

Gjatë takimit, znj. Kaçi theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, edukimin financiar dhe rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, si dhe vlerësoi veçanërisht rekomandimet e ekspertëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

Drejtuesit e lartë të OTA-s vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehën gadishmërinë për vijimin e mëtejshëm të asistencës teknike për Autoritetin.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – korrik 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - korrik 2024 kapën vlerën 14,198 milionë lekë, ose 7.58% më shumë se në janar – korrik 2023. Gjatë periudhës janar – korrik 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 870,189 me një rritje prej 9.55% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.65% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.31% dhe risigurimi me 0.042%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.96% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.04% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – korrik 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,762 milionë lekë, ose 21.50% më shumë se në periudhën janar – korrik 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar – korrik 2024 kapën vlerën 3,416 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.76% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar – korrik 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar – korrik 2024 arritën rreth 8,240 milionë lekë, ose 9.39% më shumë se në periudhën janar – korrik 2023.

# ZHVILLIME TË TJERA

---

## **Kuvendi i Shqipërisë miraton emërimin e znj. Merita Gurabardhi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv**

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 76/2024 miratoi emërimin e znj. Merita Gurabardhi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv.



## **Kuvendi i Shqipërisë voton z. Deniz Deralla, anëtar të Bordit të AMF-së**

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 77/2024 miratoi emërimin e z. Deniz Deralla në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

# Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për mënyrën, afatet dhe procedurën e pagesës së pensionit privat”



AMF - Legjislacioni - Stabiliteti Financiar - Mbrojtja e Konsumatorit - Edukimi Financiar - Regjistri i të Licencuarve - Programet

## Projektregullore

Faqe Kryesore ▶ Legjislacioni ▶ Projektakte ▶ Projektregullore

Projektregullore “Për mënyrën, afatet dhe procedurën e pagesës së pensionit privat”

Rregullore “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërise administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 73/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projekt-rregulloren “Për mënyrën, afatet dhe procedurën e pagesës së pensionit privat”


Projektregullorja e sipërpërmendur është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/pdf/fokus/Draft-RregullorePayoutPension.pdf>

Linku i projektregullores  
gendet në:

[https://amf.gov.al/pdf/fokus/  
Draft-  
RregullorePayoutPension.pdf](https://amf.gov.al/pdf/fokus/Draft-RregullorePayoutPension.pdf)

## Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat"



Linku i projektregullores  
gendet në:

[https://amf.gov.al/pdf/fokus/  
DRAFTRREG-  
INVESTIMET13\\_8\\_2024.pdf](https://amf.gov.al/pdf/fokus/DRAFTRREG-<br/>INVESTIMET13_8_2024.pdf)

Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶ Projektregullore

Projektregullore "Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat"


Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 "Për  
Fondet e Pensionit Privat", ka hartuar projekt-rregulloren:

"Mbi rregulla të mëtejshme për investimet dhe veprimtarinë e fondit të  
pensionit privat"

Projektregullorja e sipërpërmendur është publikuar në faqen zyrtare  
të Autoritetit, për konsultim publik në linkun:

[https://amf.gov.al/pdf/fokus/DRAFTRREG-  
INVESTIMET13\\_8\\_2024.pdf](https://amf.gov.al/pdf/fokus/DRAFTRREG-<br/>INVESTIMET13_8_2024.pdf)

## Autoriteti nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për përcaktimin e elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove, si dhe mënyrën e llogaritjes së tyre”



Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶ Projektregullore "Për përcaktimin e elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove, si dhe mënyrën e llogaritjes së tyre"

Projektregullore "Për përcaktimin e elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove, si dhe mënyrën e llogaritjes së tyre"

Materiali i plotë

Linku i projektregullores  
gendet në:

<https://amf.gov.al/pdf/fokus/Projektregullore-Perpercaktimineelementevedgenivelevetatarifavedhekostove.pdf>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren: “Për përcaktimin e elementëve dhe niveleve të tarifave dhe kostove, si dhe mënyrën e llogaritjes së tyre”.

Projektregullorja e sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/pdf/fokus/Projektregullore-Perpercaktimineelementevedgenivelevetatarifavedhekostove.pdf>

## BOSNJË-HERCEGOVINA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës u pranua si anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, IAIS, e cila është një organizatë me anëtarësi vullnetare e mbikëqyrësve dhe rregullatorëve të sigurimeve nga më shumë se 200 juridiksione, që përbëjnë 97% të primeve botërore të sigurimit.

Anëtarësimi i Agjencisë së Sigurimeve të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës në IAIS do të ndihmojë në krijimin e mundësive që lidhen me tejkalimin e rreziqeve të mundshme për stabilitetin e tregut të sigurimeve në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës.

Agjencia vuri në dukje se IAIS luan një rol aktiv në identifikimin dhe monitorimin e tendencave dhe sfidave të zhvillimit që mund të riformësojnë biznesin e sigurimeve. Anëtarësimi në këtë shoqatë do të mundësojë marrjen e informacionit mbi sfidat aktuale dhe të mundshme me të cilat përballlet sektori i sigurimeve të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe si edhe vetë Agjencia.

## KROACI

<https://www.hanfa.hr/news/june-2024-monthly-report/>

Sipas raportimit periodik mujor të Autoritetit Kroat të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, në qershor 2024, në treg operonin 14 shoqëri sigurimesh. Totali i primeve të mbledhura në 5-mujorin e parë të vitit 2024 arriti në 953.3 milionë euro, nga të cilat 175.5 milionë euro ose rreth 18.5% ishin prime për sigurimet e Jetës dhe 776.8 milionë euro ose rreth 81.5% ishin primet e sigurimit të Jo-Jetës. Struktura e primit të arkëtuar për tregun e sigurimit të Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjesisë për mjete motorike me 36.9%, e ndjekur nga sigurimi i mjeteve tokësore me 18.9% dhe sigurimi nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore me 9.2%.

Vlera e dëmeve të paguara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 arriti në 654.7 milionë euro. Nga kjo shumë, 259.1 milionë euro ose 39.6% kanë të bëjnë me sigurimet e Jetës, ndërsa 395.6 milionë euro ose 60.4% lidhet me sigurimet e Jo-Jetës. Në totalin e dëmeve të paguara në sigurimet e Jo-Jetës, shumat më të mëdha kanë të bëjnë me sigurimin e përgjegjesisë së automjeteve e cila zë 41.5%, sigurimin e mjeteve motorike tokësore me 22.1% dhe sigurimin nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore me 9.3%.

## MAQEDONI E VERIUT

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas njoftimeve të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut, ASO, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, pronarët e automjeteve kanë investuar 43.1 milionë euro në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive dhe policat e sigurimit të Kartonit Jeshil. Për periudhën janari-qershor 2024 janë siguruar rreth 351 mijë automjete (mjete pasagjerësh dhe mallrash, autobusë, motoçikleta, traktorë, rimorkio dhe mjete speciale).

Në Maqedoninë e Veriut veprojnë 12 kompani sigurimesh, të cilat lëshuan mbi 468.000 polica sigurimi motorik duke përfshirë edhe ato për Kartonin Jeshil dhe arkëtuan 2.65 miliardë denarë ose rreth 43.1 milionë euro. Sipas Byrosë Kombëtare të Sigurimeve, NBO, biznesi i sigurimit të përgjegjësive motorike në gjashtëmujorin e parë 2024 u rrit me 6%, e shprehur në terma vjetore, krahasuar me një vit më parë.

## POLONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacioneve të publikuara nga Dhoma Polake e Sigurimeve, PIU, primet e shkruara bruto të siguruesve polakë në tremujorin e parë të 2024 arritën në 5.1 miliardë euro (21.94 miliardë PLN), që është 18.55% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo normë shumë e lartë e rritjes ndikohet edhe nga vlerësimi prej rreth 9% në vit i monedhës polake Zloty. E llogaritur në monedhën e vendit, Zloty, rritja e tregut ishte rreth 9%.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 1.36 miliardë euro ose rreth 5.9 miliardë PLN, që është një rritje prej 6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar e shprehur në monedhën vendase PLN. Në tremujorin e parë 2024 u lidhën 23 milionë kontrata sigurimi të Jetës, nga të cilat 11.2 milionë kontrata janë lidhur nga individë, ndërsa 11.9 milionë kontrata janë lidhur në formën e sigurimit në grup. Ky numër është i krahasueshëm me atë të një viti më parë për të njëjtën periudhë.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 3.74 miliardë euro. E shprehur në monedhën lokale vëllimi i primeve ishte 16.08 miliardë PLN, me rritje prej 10.23% më shumë për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimet motorike vazhdojnë të mbajnë peshën më të madhe në biznesin e Jo-Jetës, me 47.4%, thujse e pandryshuar në vitin e kaluar.

Rezultatet e tremujorit të parë tregojnë se sigurimi motorik zë pjesën më të madhe të dëmeve të paguara nga siguruesit polakë. Dëmet e paguara nga sigurimi i detyrueshëm MTPL arritën në 704 milionë euro, 23% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të shprehura në monedhën vendase, dëmet e paguara arritën në 3,03 miliardë PLN, 13.2% më i shumë. Pavarësisht rritjes së kostove të dëmit, primi mesatar i MTPL-së u rrit me vetëm 3.7% dhe arriti në 527 PLN.

Përsa i përket linjave të sigurimit të pronës (Klasa VIII dhe IX), tremujori i parë 2024 ishte i qetë pa ngjarje ekstreme të motit. Rritja e dëmeve të paguara në këtë periudhë ishte vetëm me rreth 1% në monedhën vendase. Ndërkohë që në prill dhe maj kanë qenë mbi 20,000 raportime për dëme të lidhura me ngricat. Rreziku i klimës është vazhdimisht i pranishëm, me intensitet të ndryshëm. Mesatarisht rreth 49% e pronave janë të siguruar.

## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacioneve të publikuara nga PAID Romania, Bashkimi i Sigurimeve kundër Fatkeqësive Natyrore, deri në fund të korrikut 2024, shkalla e mbulimit kombëtar në sistemin rumun të sigurimit të detyrueshëm të banesave ishte mbi 23%. Ky rezultati vjen pas një periudhe të gjatë, kur vlera e këtij treguesi nuk e kalonte 20%. PAID Romania është polica e detyrueshme e sigurimit nga fatkeqësitë natyrore, që mbulon humbjet e shkaktuara nga përmbytjet, tërmetet ose rrëshqitjet e dheut për shtëpitë.

Në të njëjtën kohë, edhe dy tregues të tjerë u arritën: mbi 30% e shtëpive në zonat urbane tani mbrohen nga sigurimet e detyrueshme; si edhe nuk ka qark në vend me një shkallë mbulimi nën 10%.

Numri i përgjithshëm i policave aktive për sigurimin e detyrueshëm të shtëpive, në fund të korrikut ishte 2,235,771, nga të cilat 420,994 i përkisnin shtëpive në rajonin e Bukureshtit. Rajonet e Brasov, Constanta dhe Timis të cilat janë tre qarqet me numrin më të madh të policave aktive.

Bashkimi i Sigurimeve kundër Fatkeqësive Natyrore, PAID, njoftoi në një konferencë shtypi se tregu rumun i sigurimeve të banesave është i përgatitur të sigurojë kompensim të shpejtë në rast të një fatkeqësie të madhe natyrore. Po ashtu, PAID Romania njoftoi përfundimin e projektit për digitalizimin e plotë të procesit të njoftimit, vlerësimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimit për pronarët e shtëpive të prekura nga fatkeqësitë natyrore.

Vlera e policës PAID është 130 RON, afërsisht 26 euro në vit për shtëpitë e tipit A, me një shumë maksimale të siguruar prej 100,000 RON ose 20,000 euro. Ndërsa për shtëpitë e tipit B, kostoja e policës është 50 RON rreth 10 euro, me një shumë të siguruar prej 50,000 RON rreth 10,000 euro.



Për informacion të mëtejshëm  
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)